

Data: 23/07/ 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Ndërtim shkolla e Mesme e Bashkuar “Mersin Duqi”, Njësia Administrative Bërzhitë, Fshati Ibë.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 177,090,236.86 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 10 (dhjetë) muaj kalendarikë.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **177,090,236.86** (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 si dhe këstin përkatës për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse

vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **88,545,118.43** (tetëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **354,180,473.72** (treqind e pesëdhjetë e katër milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre vepikë shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.
- 1.4** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përlloraritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 88,545,118.43 (tetëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 354,180,473.72 (treqind e pesëdhjetë e katër milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. *Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e*

bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ***”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.***

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: ***“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të

punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore qe parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos ne kushte te barabarta dhe u jep mundësi te gjithe OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund te jene te paplotesuara sipas standartit.

AK ka kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gjermimi në tokë.
- NP-2 B Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-7 A Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës , vepraq kullimi dhe vaditje
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- NS-4 C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.
- NS-14 A Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj
- NS-18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari

ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1 A	Punime germimi ne toke	<i>Emërtimi i Punimeve</i>	0-21 milion
		<ul style="list-style-type: none"> • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m³,shkarkimi ne auto • Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m • Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III 	Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve 1,441,921.32
NP-2 B	Ndërtime civile dhe industriale	<ul style="list-style-type: none"> • F V konstruksione metalike te perbera • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm • F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm • Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25 • Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m • Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m³ C 16/20 • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 • Trare e arkitrare b/a C 25/30 • Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m • Brez b/a C20/25 • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 (Kafazet e ashensoreve) 	51-100 milion lek Vlera e punimeve e parashikuar ne preventiv 44,679,743.54
NP-7 A	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës , vepraq kullimi dhe vaditje	<ul style="list-style-type: none"> • Mbushje me cakell pas mureve • Mbushje me zhavorr pas mureve • Kunete e mbyllur me kapak guri me vrime per largimin e ujerave siperfaqesore te shiut • FV gjeotekstil 165g/m² • F.V. Puseta betoni me Kapak Gize 100x100x100 • FV Valvol nderprerese DN50 mm • FV Valvol moskthimi DN50 PN 6-10bar • F.V Elemente montimi dhe mberthimi.(Shirit metalik, gozhde, fasheta) • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 125 mm • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 110 mm • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 75 mm • F.V Tub shkarkimi PP d 50 mm • FV Bryl 45° PP Ø50 • FV Bryl 45° PP Ø 75 • FV Bryl 45° PP Ø 110 • FV Bryl 90° PP Ø110 per klozetat • FV Bryl 90° PP Ø 50 • FV Reduksione PP Ø75-Ø50 • F.V Reduksione PP Ø110-Ø75 • F.V Reduksione PP Ø200-Ø100 Ø200-Ø125 	0-21 milion Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve 5,363,973.03

		<ul style="list-style-type: none"> • F.V Brage PP DN 50/50 • FV Brage PP DN110/110 • FV Brage PP DN 75/50 • FV Brage PP DN 110/50 • FV Brage PP DN 110/75 • FV Brage PP DN 125/50 • FV Brage PP DN 125/110 • FV Brage PP DN 125/75 • FV Brage PP DN 125/125 • FV Qafore vete shuarse Ø 100 mm Ø 125 mm • F.V Tubo korrogato Ø 200mm dhe Ø 100 • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 160 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 200 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 250 mm • F.V Tubo I brinjezuar HDPE SN8 dn 315mm • F.V Puseta betoni (40 x 70) cm, me kapak gize me grille • V Pompe e mbrojtjes kunder zjarrit Pompe e elektrike dyshe • FV Grup saraçineske me 1 gryke lidhje hidranti 2 1/2" dhe nje gryke 2" për brigadat MNZ • F.V Tubo korrogato Ø 200mm dhe Ø 100 • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 160 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 200 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 250 mm • F.V Tubo I brinjezuar HDPE SN8 dn 315mm • F.V Puseta betoni (40 x 70) cm, me kapak gize me grille • 	
NP-11 A	<p>Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 • F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 • F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 • F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m • F.V. Percjelles shirit bakri tokezimi ,Cu=30x3mm • FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 • F.V. Kanaline e birezuar Zn 200x75 • F V. Aksesore per kanaline Zn 200x75 (Kthesa, Kryqezime, Reduktore , Nderrim plani ,kapak aksesoresh etj sipas rastit) • F.V. Separator kanaline H75 • F.V. Tub rigid PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø20mm me aksesore • F.V. Kuti shperndarese PT6 195x154x70 brenda murit • F.V. Kuti shperndarese C5 150x110x7140 IP56 jashte murit • F.V. Tub korrugato dopioshtres D63 • F.V. Kabell 4x185mm FG16R16 • F.V. Kabell 4x70mm+1x35mm FG16R16 • F.V. Kabell 4x50mm+1x25mm FG16OR16 • F.V. Kabell 5x2,5mm FTG10OM1 • F.V. Kabell 5x16mm FG16OM16 • F.V. Kabell 5x10mm FG16OM16 • F.V. Kabell 5x6mm FG16OM16 • F.V. Kabell 5x2,5mm FG16OM16 • F.V. Kabell 5x1,5mm FG16OM16 • F.V. Kabell 3x2.5mm FG16OM16 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve</p> <p>5,812,721.74</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • F.V. Kabell 3x1.5mm FG16OM16 • F.V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module e bardhe • F.V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module e kuqe • F.V. Kuti ne dysHEME (torret) 12 Module • F.V. Kuti per celesa e priza 3-module, suport , kapak & tapa per instalim brenda murit . • F.V. Kuti per celesa e priza 4-module, suport , kapak & tapa per instalim brenda murit . • F.V. Celes 1P 10A • F.V. Pulsant per komandimin e ndricimit, 10A • V. Ndricules plafon 5-10W • V. Ndricules LED 60x60 36W • F.V. Percjelles hekuri i zinkuar D8mm • F.V. Tabele impiant tokezimi 250x150mm • F.V. Morsete, shkeputes per matje tokezimi • F.V. Morsete fiksimi universale • F.V. Kuadri Elektrik Kryesore - 1.1 (Sipas skemes dhe konform normave dhe standarteve ne fuqi) • F.V. Kuadri Elektrik - 1.2 (Sipas skemes dhe konform normave dhe standarteve ne fuqi) • F.V. Kuadri Elektrik Kryesore - 2 (Sipas skemes dhe konform normave dhe standarteve ne fuqi) • F.V. Kuadri Elektrik - 3 (Sipas skemes dhe konform normave dhe standarteve ne fuqi) • F.V. Kuadri Elektrik - Mekanika (Sipas skemes dhe konform normave dhe standarteve ne fuqi) • Ndricules plafon 5-10W • Ndricules evakuimi me llampe 1x1w,IP40 • Ndricules LED 60x60 36W • 	
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> • F.V. Fidane Peme dekorative • Sistemim, nivelim dhe pasurim me humus 5kg/m2 • Mbjellje bari ne skarpat 	0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 319,156.09
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Prishje mur tulle me pastrim • Prishje çatie ekzistuese me tjegulla • Prishje struktura prej betoni 	0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 2,885,251
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> • F.V lavaman porcelani • F.V WC allafrenga • Montim pompe zhytесе • F.V lavaman porcelani importi me mishelator per PAK • F.V WC allafrenga importi per PAK • V. Bojler elektrik, kapaciteti 80 lit. • V. Bojler elektrik, kapaciteti 12 lit. • F.V minivalvola nderprerese te paisjet hidrosanitare • FV Filter uji me rrjete DN 50 Pn 10 • FV Valvol nderprerese DN50 mm 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 1,811,761.4

		<ul style="list-style-type: none"> • FV Valvol moskthimi DN50 PN 6-10bar • F.V Elemente montimi dhe mberthimi.(Shirit metalik, gozhde, fasheta) • V Pompe e mbrojtjes kunder zjarrit Pompe e elektrike dyshe • V Fikse zjarri portabel me pluhur, 6kg, tipi 34A 233BC • V Fikse zjarri portabel me CO2, 5kg, tipi 113B, per ambjentin e kabines elektrike ose pajisje elektrike • FV Lidhja me motopompen (AL-5121-B) • F.V Hidrant Zjarri i (AL-52121-B) • FV Fikese zjarri me pluhur dhe CO2 (AL-5203-B) • FV Buton sinjalizimi zjarri (AL-5102-B) • F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshem. Kasete brenda murit, llamarine çeliku e • V Rezervuare uji vertikale - zingato per ujin sanitar dhe MNZ ME d= 1600 mm dhe H= 2660 mm me lidhje 11/2 " • V Zbutes Uji Karakteristikat teknike Prurja max 7.0 m³/h Kripe 52.4 kg • V Pompa e sitemit te ujit sanitar me dy pompa me shume shkalle , me inverter • Bojler elektrik, kapaciteti 80 lit. • Bojler elektrik, kapaciteti12 lit. • Pompe e mbrojtjes kunder zjarrit Pompe e elektrike dyshe - Fuqia e instaluar (2x5.5) kW, In =2x10.5 A, 3F- 400V- 50Hz - Prurja 18 m³ / h, Prevalenca 60 mkH2O - Presioni punes 6 bar, presioni max 16 bar • Fikse zjarri portabel me pluhur, 6kg, tipi 34A 233BC • Fikse zjarri portabel me CO2, 5kg, tipi 113B, per ambjentin e kabines elektrike ose pajisje elektrike • Rezervuare uji vertikale - zingato per ujin sanitar dhe MNZ ME d= 1600 mm dhe H= 2660 mm me lidhje 11/2 " • Zbutes Uji Karakteristikat teknike Prurja max 7.0 m³/h Kripe 52.4 kg Cikli 2100m³ x° f Lidhjet 11/4 • Pompa e sitemit te ujit sanitar me dy pompa me shume shkalle , me inverter me karakteristika teknike per Objektin • "Pompe nxehtesie me kompresor inverter tip ""scroll"" per sisteme aplikimi VRV. me kontroll te temperatures se freonit ne dalje. me kapacitet termik ne ftohje 42.1 kW. kapacitet termik ne ngrohje 46.7 kW. i kondensuar me ajer. COP 4 EER 3.5. " • Pompe zhytесе 	
NS-3 A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim ashensori PAK, 3 ndalesa • FurV. ashensori PAK, 3 ndalesa • V. ashensori PAK, 3 ndalesa • V. ashensori PAK, 2 ndalesa 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 4,000,000.01</p>

<p>NS-4 C</p>	<p>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm • Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B • Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B • Kasete shkarkimi me llamarine xingat • Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 • Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama • Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm • Mbulim çatie me panele sanduich • Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama • Shtrese me pllaka porcelanat • Shtrese parketi • Shkalle montazhi mermeri • Nenshtrese zhavori • Shtrese betoni C 12/15 • Shtrese me pllaka mermeri t=2cm • Shtrese me pllaka mermeri t=3cm • Shtrese rere • Shkalle montazhi mermeri • Shtrese rere • Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri • Plintuse mermeri h = 10cm • Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah • Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 • Suvatim me grafiato h > 4 m • Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm • Patinim tavani allçi (stuko) • Plintuse grez h = 10 cm • Plintuse mermeri h = 10cm • Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm • Boje hidroplastike • Boje hidroplastike cilesi e larte • Boje vaji siperfaqe metalik • F.V porte metalike dekorative rreshqitese • F V dritare d/alumini plastike me dopio xham • Dyer d/alumini me mbushje element d/a. • F V dyer d/alumini plastike me dopio xham • F V dyer te brendeshme druri cilesi e II-te. • Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 (Kafazet e ashensoreve) • Shirita adezive te ashper 30 cm per orientimin e PAK • FV Veshje muri me polisterol te thjeshte t=8cm rrjete+suva. • me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 (Kafazet e ashensoreve) • FV Veshje muri me polisterol te thjeshte t=8cm rrj Kapuc parapeti me llamarine me boje te pjekur • F.V Strehe ne hyrje me polikarbonat • F.V Dyer metalike 100x220 me mekanizem antipanik • FV Parket Lis masiv R 21 x 50 x 400 mm, perfshire ristelat, nenshtresen, vidat, astarin dhe llakun si edhe plintusat 	<p>51-100 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>66,072,447.0 9</p>
---------------------------------	--	--	---

		•	
NS-12 A	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	<ul style="list-style-type: none"> • V. Detektor optik Tymi I adresueshem • F.V Kapuç ajrimi ne tarrace vertikal Ø 110mm Ø 125 mm • FV Elemente mberthyes e fiksues • F.V Tub plastik ventilimi PP • F.V Elemente montimi dhe mberthimi. (upa, fasheta, prizhioner, profile metalike, stafa, bulloneri,Upa metalike betoni, Gur fresibel, etj) • Grile per thithjen e ajrit. ne forme rrethore mm Ø 100 mm • Kondra valvul D100 mm • F.V Bashkues antivibrues per aspiratoret e ajrit • "V Ventilator ne linje - Kapaciteti: 125 m³/h; - Fuqi nominale max – 13 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 50 Pa." • "V Ventilator centriugal - Kapaciteti: 1100 m³/h; - Fuqi nominale max – 200 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 150 Pa." • "V Ventilator centriugal - Kapaciteti: 1500 m³/h; - Fuqi nominale max – 200 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 150 Pa." • Gaz frigoriferik • V. Pompe nxehtesie me kompresor inverter tip "scroll" per sisteme aplikimi VRV. • V. Pompe nxehtesie me kompresor inverter tip "scroll" per sisteme aplikimi VRV. • V. Pajisje kasete me fuqi termike ne ftohje 2.2 kW. fuqi termike ne ngrohje 2.5 kW • V. Pajisje kasete me fuqi termike ne ftohje 2.7 kW. fuqi termike ne ngrohje 3.0 kW • V. Pajisje kastete me fuqi termike ne ftohje 5.6 kW. fuqi termike ne ngrohje 6.0 kW • V. Pajisje kastete me fuqi termike ne ftohje 6.5 kW. fuqi termike ne ngrohje 7 kW • V. Komanda murale me funksion te termostatit. programatorit ditor dhe javor. me kontroll dhe diagnostikim individual te çdo Pajisje te brendshme VRV. Panel qendror monitorimi per sistemin VRV (VRF) • V. Lidhja me kabell 2x1.0 mm • Ventilator ne linje - Kapaciteti: 125 m³/h; - Fuqi nominale max – 13 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 50 Pa. • Ventilator centriugal - Kapaciteti: 1100 m³/h; - Fuqi nominale max – 200 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 150 Pa. • Ventilator centriugal - Kapaciteti: 1500 m³/h; - Fuqi nominale max – 200 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 150 Pa. • "Pompe nxehtesie me kompresor inverter tip ""scroll"" per sisteme aplikimi VRV. me kontroll te temperaturese freonit ne dalje. me kapacitet termik ne ftohje 42.1 kW. 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>16,581,955</p>

		<p>kapacitet termik ne ngrohje 46.7 kW. i kondesuar me ajer. COP 4 EER 3.5. "</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Pompe nxehtesie me kompresor inverter tip ""scroll"" per sisteme aplikimi VRV. me kontroll te temperatures se freonit ne dalje. me kapacitet termik ne ftohje 76.5 kW. kapacitet termik ne ngrohje 79.2 kW. i kondesuar me ajer. COP 4 EER 3.5. " • Pajisje kasete me fuqi termike ne ftohje 2.2 kW. fuqi termike ne ngrohje 2.5 kW • Pajisje kasete me fuqi termike ne ftohje 2.7 kW. fuqi termike ne ngrohje 3.0 kW • Pajisje kastete me fuqi termike ne ftohje 5.6 kW. fuqi termike ne ngrohje 6.0 kW • Pajisje kastete me fuqi termike ne ftohje 6.5 kW. fuqi termike ne ngrohje 7 kW • Komanda murale me funksion te termostatit. programatorit ditor dhe javor. me kontroll dhe diagnostikim individual te çdo Pajisje te brendshme VRV. Lidhja me kabell 2x1.0 mm • Panel qendror monitorimi per sistemin VRV (VRF) • Njesi kompakte per montim horizontal e tipit "Rooftop". E kompletuar me te gjitha aksesoret e nevojshem. Njesi pompe nxhetesie me kompresor scroll inverter, kapacitet Ftohje/ngrohje Q=155.7/162.9 kw • Komanda murale me funksion te termostatit per kontrollin e ventilimit 	
NS-14 A	Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	<ul style="list-style-type: none"> • V. High-bay 74W 4000K PSU WB 136lm/W • V. UPS 600VA 1:1 (1-fazor) me autonomi 15min • V. Prozhektor LED 100W 12000lm 6000K IP65 I zi • V. Rack 19" 15U, I pajisur me rrota, aksesore montimi shina, dere xhami etj • V. Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6 • V. Priza rrjeti tip RJ-45, cat 6, FTP, Kompletuar me adaptor • V. Patch guide per sistemimin e kabujve • V. Switch 24P 10/100/1000Mbps 1U • V. Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=1.5 m • V. Panel me 4 ventilator me termostat • V. Suport 6 priza PDU 19" 1HE 16A • F.V. Kabell rrjeti kompjuterik, Tipi FTP-cat6 • V. Kamera IP Dome 5MP (2.8mm) IR(30m) IP66 • V. Kamera IP Bullet 5MP (2.8mm) IR(30m) IP66 • V. NVR me 32 kanale, 4Slote HDD, RAID, IN/OUT Bandwidth 320mbps • V. Switch 24P POE+ • V. HDD 8 TB surveilance deticated • High-bay 74W 4000K PSU WB 136lm/W • UPS 600VA 1:1 (1-fazor) me autonomi 15min • Prozhektor LED 100W 12000lm 6000K IP65 I zi • Rack 19" 15U, I pajisur me rrota, aksesore montimi shina, dere xhami etj • Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6 • Priza rrjeti tip RJ-45, cat 6, FTP, Kompletuar me adaptor • Patch guide per sistemimin e kabujve • Switch 24P 10/100/1000Mbps 1U • Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>2,348,785.97</p>

		L=1.5 m <ul style="list-style-type: none"> • Panel me 4 ventilator me termostat • Suport 6 priza PDU 19" 1HE 16A • Kamera IP Dome 5MP (2.8mm) IR(30m) IP66 • Kamera IP Bullet 5MP (2.8mm) IR(30m) IP66 • NVR me 32 kanale, 4Slote HDD, RAID, IN/OUT Bandwidth 320mbps • Switch 24P POE+ • HDD 8 TB surveillance deticated • Monitor LED, 32", FULL HD, HDMI/VGA 	
--	--	---	--

N.N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-2 B (Ndërtim civile dhe industriale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtimin e një objekti civil, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-7A Ujësjetës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per Ujësjetës, kanalizime, sistem vaditje etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-7A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtim për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, vepra kullimi e vaditje, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-1 A (Punime per prishjen e ndërtimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje te strukturave te betonit , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-2 A(Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me impiantet hidro-termosanitare si sistemi kundra zjarri , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-3 A(Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka vendosjen e ashensorve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e muraturës te godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit te godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS- 14 Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e sistemit të kamerave të godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-18 A.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e një shkolle dhe një, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.S 18 A ku është pjesë e rëndësishme punimet topografike.

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për

ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

4. Një punësim mesatar i të paktën **65** (gjashtëdhjetë e pesë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
 - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
 - b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjisllacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 65 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 10 muajve

kalendarike, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) arkitekt;
- 1 (një) inxhinier mekanik.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (e ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar N.P –1A, N.P –4D, N.S – 6A, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit dhe arkitektit.**

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP7 A**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik.**

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP11 B**, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS 18**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit te Mjedisit.**

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS3 dhe NS12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Mekanik.**

6. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikës ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “*Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin*“, ku citohet se: “*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit*”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
 - a) 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e

shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

- b) 2 (dy) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 1 (një) Teknik mekanik
- 1 (një) punonjes hidraulike
- 1 (një) punonjes elektriciste
- 1 (një) punonjes mekanik
- (dy) punonjes bojaxhi
- (dy) punonjes muraturë
- 1 (nje) punonjës saldator

- 1 (një) punonjës hidroizoules
- 1 (një) punonjës pllakashtrues

Punonjës Manovrator (shofer)

- 1 (një) punonjës eskavatorist;
- 1 (një) punonjës automakinist.

8.1 Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale e punës;
- b) Per tekniket e ndertimit dhe mekanik diplomën perkatëse, ndersa per punonjesit e tjere diplome/certifikate që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetërore ne Republikën e Shqiperise;
- c) Dëshmi Kualifikimi te sigurimit teknik e vlefshme, e cila duhet te jete e lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve;
- d) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

8.2 Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste dhe automakinist, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr.15/2017 “PËR ARSIMIN DHE

FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 1 (dy) Teknik ndertimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

1 (një) teknik mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

1 (një) punonjes hidraulike prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

1 (një) punonjes elektriciste prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

1 (një) punonjës mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

2(dy) punonjes bojaxhi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

2(dy) punonjes murature prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike .

1 (një) eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) punonjës hidroizoules kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) automekanist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet elektrike, tuba, hidroizolues. Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimi CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara në Specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të

VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie , certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkëkohore.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 10 (jetë) muaj kalendarikë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 dhe kane të bëjnë me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit të punimeve.

11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- d. Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që

veprimtaria e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
	Autovinç 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
1	Vinç kulle deri ne 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vinç kulle deri ne 5-10 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Trapano	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Betonjere 500l	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator thellesie	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator sipërfaqësor	copë	1	Në pronësi ose me qera

11	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Eskavator 0.25m3 me gome	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Elektrosaldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -10Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në

dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

- Dokumentet perkatëse vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fuesit do t'i kerkoje ofertuesit te kualifikuar nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik qe te dorëzoje dokumentet provuese per vetedeklarimet e bera ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, si dhe dokumentet e tjera te paraqitura ne sistemin elektronik te prokurimit gjate fazes se ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit te sipercituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Ndodhur ne kushtet ku lloji i procedures se prokurimit eshte "Procedure e Hapur mbi kufirin e Lartë monetar" mbështetur ne Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 56, pika 2 si dhe referuar VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 24, pika 3, Njoftimi i kontratës mbi kufirin e lartë monetar do të botohet edhe në Gazetën zyrtare të Bashkimit European.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit gjykon se duhet të parashikohen dhe rastet kur Ofertues janë Operatorë të huaj ekonomik, të cilët duhet t'i paraqesin dokumentat e kërkuara sipas Kritereve të Përgjithshme dhe Kritereve të Veçanta të Kualifikimit sipas formës ligjore të specifikuar në rubrikën Shënim. Njëshmjet këtyre kërkesave, Njësia e Prokurimit synon të nxisë konkurrencën midis operatorëve ekonomik dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik (shqiptar ose të huaj) sipas parashikimeve të Nenit 2 të LPP-së.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".